



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

01. -12- 2023

Ref. 2312/1211/KPM/jm

Klan Kosova
Barlet Imami
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

Lidhur me Rastet: nr.2023/160 Daut Qulangji, nr.2023/162 Sonat Begaj, nr.2023/170 Mirlinda Gixholi dhe nr.2023/174 Diana Basha – (Palët ankuese) kundër Klan Kosova (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 21 tetor 2023 ka pranuar një Ankesë nga z. Daut Qulangji (Palë Ankuese), ndaj transmetimit të emisionit “Reality Show Big Brother Vip 2”, me pretendimin se gjatë këtij spektakli është bërë ofendim në baza etnike, duke theksuar se: “Në natën e parë të spektaklit Big Brodher VIP Kosova spektakël i cili emetohet në televizionin Klan Kosova, ku në hyrjen e banorëve të kësaj shtëpie është përdorur fjala pezhorative, ofenduese, denigruese në baza etnike nga një banore e kësaj shtëpie, duke thënë se: “Mos ma merrni për të madhe që po flas ashtu shqipen si një magjupe...”
3. KPM me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, me datën 23 tetor 2023 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për Ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet ankimore.
4. Pala Përgjegjëse me datë 27 tetor 2023 i është përgjigjur kërkesës së KPM-së, përmes së cilës thekson se si produktioni, ka kërkuar falje të sigjerta dhe kanë shprehur keqardhje si ndaj KPM-së, ashtu edhe ndaj të gjithë teleshikuesve për rastet në fjalë, të cilët kanë mundur të ndjehen të ofenduar, specifikisht shprehim keqardhje për komunitetin egjiptian (ashkali/romë) të cilët kanë mundur të ndjehen të ofenduar nga shprehja e banores në fjalë.
5. KPM në lidhje me këtë çështje, bazuar në Raportin e monitorimit të datës 31 tetor 2023, ka gjetur se Pala Përgjegjëse, respektivisht moderatori i emisionit ka reaguar dhe sqaruar se ofendimi nuk ishte i qëllimshëm ndaj ndonjë komuniteti dhe se Pala Përgjegjëse ka ndërmarr veprimet e menjëhershme për evitimin e gjuhës vulgare dhe ofenduese, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

6. KPM me datën 7 nëntor 2023 i ka dërguar përgjigje në Ankesë Palës Ankuese përmes të cilës e ka njoftuar se ka proceduar me ankesën dhe ka gjetur se Pala përgjegjëse, ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, pasi që moderatorin e emisionit "Prime i Big Brother Vip 2" gjithashtu edhe banorja në fjalë kanë ndërmarrë veprime të menjëhershme, duke kërkuar falje publike lidhur me gjuhën ofenduese që ka ndodhur në emisionin e lartcekur.
7. KPM me datën 23 tetor 2023 ka pranuar një Ankesë nga z. Sonat Begaj (Palë Ankuese), ndaj transmetimit përmbledhjes ditore të emisionit "Reality Show Big Brother Vip 2", me pretendimin se *"Klan Kosova ka shfaqur insertin nga Big Brother ku kemi fjalosje e agresivitet banal nga dy pjesëtar të kësaj shtëpie, që po i thonë. Këto janë shembuj shumë të këqinj që na serviren në shpirtë tona, fëmijët tonë po na stresohen e edukohen keq me kësi pamje e ku kemi edhe fyerje, ku njëri banor i thotë tjetrit Lopë, e ku te ne fjala lopë është fyerje."*
8. KPM me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, me datën 25 tetor 2023 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për Ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
9. Pala Përgjegjëse me datë 27 tetor 2023 i është përgjigjur kërkesës së KPM-së, përmes së cilës thekson se *"...Lidhur me ankesën e tretë të paraqitur po ashtu produksioni ka ndërmarrë veprimet e duhura dhe veç e veç i ka ftuar banorët në dhomën e rrëfimeve për të ju tërhequr vërejtjen që të njëjtit të kenë kujdes të shtuar për fjalorin të cilin mund ta përdorin pa dashje nga gjendja afërtit ashtu që gjatë diskutimeve mund të ju rrëshqasin pa dashje fjalë jo adekuate dhe pa përshtatshme për transmetim. Të njëjtat instruksione produksioni iu ka dhënë banorëve edhe para hyrjes në shtëpi dhe po ashtu të njëjta rregulla të mirësjelljes i kanë të nënshkruar në kontratat e tyre të lidhura me produksionin për pjesëmarrje në këtë "reality shoë televiziv."*
10. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të datës 2 nëntor 2023, ka gjetur se në Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të këtij Reality Show, konkretisht rreth orës 18:51 min, gjatë një debati në mes të banorëve është përdorur gjuhë vulgare dhe ofenduese, përkatësisht shprehjen "çfarë llope", duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
11. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 2 nëntor 2023 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar që në afat prej tri (3) ditëve, nga pranimi i shkresës, të njoftoj me shkrim për të gjitha masat e ndërmarra për të vepruar në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03.
12. KPM më datën 14 nëntor 2023 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse në të cilën thuhet se: *"Produksioni dhe transmetuesi në vazhdimësi që nga fillimi i këtij programi kanë ndërmarrë masat e duhura, dhe serioze dhe preventive që mos të përsëriten shprehjet dhe komunikimet e papërshtatshme dhe ofenduese në mes të banorëve, ku si dëshmi me e mirë dhe shume konkrete e kësaj është edhe përjashtimi automatik i njërit prej banorëve -Meti Alshiqi, ku me dt. 14.11.2023, rreth orës 19:00h, produksioni i këtij programi pikërisht për shkak të gjuhës se ashpër, sjelljeve ofenduese dhe të papërshtatshme, si dhe veprimeve jo në përputhje me rregullat dhe sjelljet që duhet të behën brenda këtij formati. është larguar me automatizëm nga gara/loja e "Big Brother", ku paraprakisht ndaj të gjithë banorëve është bërë thirrje për vetëpërmbytje dhe mirësjellje gjatë komunikimit, thirrje kjo që nuk është përfillë nga banori në fjalë, me ç'rast produksioni me automatizëm e ka nxjerre nga shtëpia banorin, për shkak të*

shkeljes se rregullave të lojës por edhe për shkak se kemi vlerësuar se sjelljet e këtij personazhi nuk janë në harmoni dhe pajtim me Rregulloret KPM-së dhe pa u hamendësuar jemi obliguar që banorin në fjalë ta nxjerrim nga shtëpia, ku vlerësojmë se kjo do të jetë një preventive dhe adut shtesë që banorët duhet të kenë kujdes mbi fjalorin dhe sjelljet e tyre brenda shtëpisë, por edhe në anën tjetër ky shpresojmë të jetë sinjal edhe për palët ankuese si dhe për KPM-se për përkushtimin dhe seriozitetin që ka produktioni dhe transmetuesi në raport me atë se çfarë transmetohet dhe me përkushtimin tonë që të jemi në pajtueshmëri me Kodin e Etikes se KKPM-së”.

13. KPM me datën 23 tetor 2023 ka pranuar një Ankesë nga znj. Mirlinda Gixholli (Palë Ankuese), ndaj transmetimit përmbledhjes ditore të emisionit “Reality Show Big Brother Vip 2”, me pretendimin se gjatë këtij spektakli po promovohet pirja e duhanit nga banorët e kësaj shtëpie dhe ka pamje të pahijshme, duke theksuar se: *“Me datën 20 tetor kur sapo filloj Big Brother menjëherë u shfaqen pamje të pahijshme rreth orës (9) kur te gjithë fëmijët ishin zgjuar. Gjithashtu ditëve në vazhdim ka pasur fjalosje idiotesh, dhe besoj qe e keni parasysht këtë dhe jeni duke monitoru. Pirja e duhanit është promovu në këtë kanal...”*
14. KPM me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, me datën 25 tetor 2023 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për Ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
15. Pala përgjegjëse me datë 27 tetor 2023 i është përgjigjur kërkesës së KPM-së përmes së cilës thekson se: *“Në ankesën e Palës ankuese e vlerësojmë si ankesë jo serioze dhe të paqëndrueshme e cila ka të bëjë në shijen dhe përshtypjen personale të ankuseses, ndërsa dihet fare mirë se shija në dukje dhe në të veshur është shumë relative dhe personale. Lidhur me atë se fëmijët kanë qenë zgjuar, sinqerisht kjo është çështje shumë subjektive dhe mbetet në përgjegjësinë e prindërve të vendosin se a ju lejojnë fëmijëve të tyre të shikojnë një reality show të tillë.”*
16. KPM bazuar në Raportin e monitorimit të datës 14 nëntor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit emisionit “Prime i parë Big Brother Vip 2”, është konsumuar /pirë duhan dhe cigare elektronike nga banorët por nuk ka pasur vendosje të produktit duke identifikuar ndonjë shenjë dalluese apo markë të caktuar e cila do të mund të konsiderohej si promovim i përdorimit të cigareve.
17. KPM me datën 30 tetor 2023 ka pranuar një Ankesë nga znj. Diana Basha (Palë Ankuese), ndaj transmetimit të emisionit “Reality Show Big Brother Vip 2”, me pretendimin se gjatë këtij spektakli ka pasur sjellje të pahijshme, fyerje, përçmime dhe shkelje të dinjitetit njerëzor, duke theksuar se: *“Klan Kosova në programin e Reality show BiG Brother Vip Kosova 2,ka pasur sjellje të pahijshme, fyerje, përçmime dhe shkelje të dinjitetit njerëzor, si dhe janë paraqit pamje me këto shprehje si: e keqe sa t dush, budallicë, katunare, çfarë rrene, o ti haluc, je i keq. Me sjellje të tilla jam ndi shumë e fyer me këtë çfar kamë parë, ku me këto sjellje primitive po na i edukojnë fëmijët dhe gjeneratat e reja shumë keq.”*
18. KPM me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, me datën 31 tetor 2023 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për Ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
19. Pala përgjegjëse nuk ka kthyer përgjigje edhe pas dërgimit të kërkesës për sqarim.

20. KPM bazuar Raportin e monitorimit të datës 14 nëntor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të programit Reality Show Big Brother Vip 2, konkretisht në prime të datës 30 nëntor 2023, ka transmetuar gjuhë vulgare dhe ofenduese, para kohës së kufizimit, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
21. KPM me datën 4, 5 dhe 11 nëntor 2023 ka pranuar edhe tri Ankesa nga ankuesja znj. Diana Basha, ndaj transmetimit të emisionit “Reality Show Big Brother Vip 2”, me pretendimin se gjatë këtij spektakli ka pasur sjellje të pahijshme, fyerje, përçmime, gjuhë ofenduese dhe shkelje të dinjitetit njerëzor, duke theksuar se: *"Gjatë transmetimit të prime në Klan Kosova në programin e Reality show BiG Brother Vip Kosova 2, një pjesëtare e stafit të emisionit iu drejtua një personi që merr pjesë në shpi me shprehjen: "A e ki pare veten në pasqyre". Kjo është një fyerje e rënde që edhe rrugëve me ndodh mund të behet belaja. Kësi nënçmimi i behet personit dhe nuk kemi reagim nga KPM! Ofendimet dhe gjuha ofenduese nuk duhet të tolerohen. Dinjiteti i secilit individ duhet të mbrohet, se paku në televizion. Kërkoj të sanksionohet dhe ndërprehen menjëherë këto shfaqje në tv-te tona, e përveç kësaj dua edhe të pyes, a lejohen me Kodin e Etikes në KPM këto shkelje që janë ba krejt normale tash ngase po shfaqen thuaja çdo ditë? A ish dashtë sipas Kodit të Etikes se KPM që deri tash të reagohej edhe a ka mandat këshillues KPM apo ka fuqi ligjore me vu në funksion Kodin e Etikes? Pse nuk ka ende reagim nga KPM? Presim reagimin tuaj dhe mbrojtjen e publikut".*
22. KPM me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore, me datën 7 dhe 13 nëntor 2023 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për Ankesat e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
23. Pala përgjegjëse me datë 17 nëntor 2023 i është përgjigjur kërkesave të KPM-së përmes së cilës thekson se: *"Për më tepër në Prime-n që do të transmetohen, moderatorët e programit do të bëjnë apel dhe thirrje përsëri dhe do të tërheqin vërejtjen publike ndaj banorëve për sjelljet dhe gjuhën korrekte që duhet ta përdorin dhe thirrja apo apeli (teksti që do të lexohet në PRIME, është si vijon: "**Banor**, Ju njoftojmë se formati i "Big Brother" monitorohet nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i cili është tejet profesionist në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij. Duke e ditur se këtë format (Big Brother) e shohin të gjitha grup-moshat, duke përfshirë edhe fëmijët, Ju bëjmë me dije se duhet të jeni vigjilent dhe të kujdesshëm me gjuhën dhe fjalorin tuaj që përdorni gjatë komunikimit brenda shtëpisë, në mënyrë që të jemi në pajtueshmëri me rregulloret, përkatësisht me Kodin e Etikes së KPM-së. Ndonëse Vëllai i Madh ju ka paralajmëruar disa herë që të jeni më të përmbajtur, ju kërkojmë edhe tani publikisht, që gjatë komunikimit që kenë së bashku, tu përmbaheni normave etike duke mos tejkalar dhe përdorur fjalor dhe shprehje ofenduese dhe jo adekuate".* Në përgjigjen e Palës përgjegjëse ndër të tjera është thënë se Pala Përgjegjëse është e gatshme që të veproj në pajtueshmëri me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së dhe gjithashtu të përmbush kontratën me kompaninë holandeze për realizimin e këtij reality show. Gjithashtu Pala përgjegjëse sqaron për KPM-në dhe Palët ankuese se ky format televiziv është një Reality Show që pasqyron përmes ekranit sjelljet dhe reagime reale dhe instiktive të njerëzve në një lojë dhe përfaqësojnë vetëm veten e tyre dhe jo një komunitet, vend apo rajon.
24. KPM bazuar Raportin e monitorimit të datës 22 nëntor 2023, ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të programit Reality Show Big Brother Vip 2, ka transmetuar gjuhë vulgare dhe ofenduese, para kohës së kufizimit, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Analiza ligjore

25. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

26. KPM bazuar në Raportet e monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse edhe pas kërkesave për sqarim dhe Njoftimit për shkelje, ka vazhduar të transmetoj material që përmban gjuhë vulgare dhe ofenduese para kohës së kufizimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 i cili përcakton se:

“OSHM nuk duhet të transmetojnë para kohës së kufizimit (nga ora 24:00 në 05:00) asnjë material që përmban gjuhë vulgare dhe ofenduese.”

27. Prandaj KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka transmetuar material që përmban gjuhë vulgare dhe ofenduese para kohës së kufizimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

28. KPM gjithashtu, bazuar në raportin e monitorimit të datës 31 tetor 2023, ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka ndërmarr veprimet e menjëhershme për evitimin e gjuhës vulgare dhe ofenduese, me qëllim të veprimit në pajtim me nenin 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 i cili përcakton se:

“Në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista etj), është obligim i OSHM-së që të ndërmarr veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofendues nga ana e pjesëmarrësve.”

29. Komisioni si rrethanë lehtësuese për Palën përgjegjëse merr faktin se, Pala përgjegjëse ka ndërmarr veprime për evitimin e gjuhës vulgare dhe ofenduese, ashtu siç përcaktohet me nenin 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

30. Pala përgjegjëse, sanksionohet me gjobë në shumën prej pesëmijë (5000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03.

31. Pala përgjegjëse obligohet që në të ardhmen të ketë kujdes në lidhje transmetimin e programeve të cilat përmbajnë gjuhë vulgare dhe ofenduese dhe të njëjtat mos të transmetohen para kohës së kufizimit, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 4, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

1. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

2. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI
Kryetar



24.11.2023

Datë